

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITEN	
02 Ng./Bc	1353/19
Ng./Bc	-07-
Ditë / Datum	02.12.2019
VUSHTRI - VUČITEN	

BAZUAR NË MARRËVESHJEN E FINANCIMIT NDËRMJET PROGRAMIT PËR ZHVILLIM TË KOMBEVE TË BASHKUARA DHE KOMUNËS SE VUSHTRRISË, NR 61, DATA 08.05.2019

Lidhet

MARRËVESHJE PËR REALIZIMIN E MASËS AKTIVE TË TREGUT TË PUNËS

PRAKTIKË NË PUNË

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (më tej referuar si "ALMP2-UNDP"), me adresë rr. "Zagrebi" nr. 58, Prishtinë, Kosovë,

Punëdhënësi: KOMUNA VUSHTRI, adresa "Isa Boletini" nr 44, Vushtri Kosovë

Praktikantët (më tej referuar sipas paragrafit 3.1 për skemën Praktikë në Punë)

Janë pajtuar si në vijim:

Neni 1

Hyrje

Duke ju referuar nenit 6 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe nenit 7 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të Ligjit 04/L-205, nenit 4, 13, 14, 15, 16, 37, 38, 39 të Rregullores 01/2018 si dhe pa përjashtuar dispozitat tjera ligjore të rregullores në fjalë dhe legjislacionit tjetër të aplikueshëm.

Neni 2

Qëllimi

- 2.1. Masa aktive të tregut të punës Praktikë në punë nënkuptojn masën aktive të tregut të punës, që synon t'iu ofrojë pjesëmarrësve njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat, të cilat janë të nevojshme për të kryer punë specifike brenda mjedisit të punës. Praktika në punë ofrohet për të rritur perspektivat e të papunësuarve të regjistruar për punësim duke përfituar njohuri dhe shkathtësi themelore për kryerjen e një pune gjatë angazhimit në punën produktive, ku qëllimi i marrëveshjes në fjalë mundëson që krahas legjislacionit referues si dhe dispozitave tjera të aplikueshëm të përcaktoheni të drejtat dhe detyrat-përgjegjësitë për palët me qëllim të realizimit të masës aktive përkatëse.
- 2.2. Punëdhënësit i lejohet të ofroj praktikë në të njëjtën kohë, brenda skemës Praktikë në punë më shumë se një punëkërkues që është i regjistruar i papunë, në përputhje me kapacitetet e tij.

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Palëve

Neni 3 Punëdhënësi

- 3.1. Punëdhënësi pajtohet që të angazhoj praktikantët si në vijim për masën aktive të tregut të punës
- Praktikë në Punë:**

Nr.	Emri dhe mbiemri kandidatit/es	Titulli/Profesioni	Periudha e Praktikës (datat)	
			Fillimi	Përfundimi
1	Majlinda Salihu	Mireqenie dhe kujdesi i femijeve	25/11/2019	24/05/2020
2	Linda Gashi	Zyra e Personelit	25/11/2019	24/05/2020
3	Mirjeta Trepca	Mireqenie dhe kujdesi i femijeve	25/11/2019	24/05/2020
4	Atëdhedona Kosumi	Financa	25/11/2019	24/05/2020
5	Syleme Sadiku	Drejtorja për buxhet dhe Financa	25/11/2019	24/05/2020
6	Liridona Segashi	Zyra për infomim	25/11/2019	24/05/2020
7	Aferdita Kajtazi	Arsim institucioni parashkollor	25/11/2019	24/05/2020
8	Albanë Xhema	Drejtorja për buxhet dhe Financa	25/11/2019	24/05/2020
9	Doruntina Mulaku	Administratë	25/11/2019	24/05/2020
10	Diellona Berisha	Arsim institucioni parashkollor	25/11/2019	24/05/2020
11	Dafina Azemi	Inspektion ushqimor	25/11/2019	24/05/2020
12	Pajtime Ismajli	Zyra ligjore	25/11/2019	24/05/2020
13	Qendresa Jashanica	Administratë	25/11/2019	24/05/2020
14	Zylfije Rekalija	Zyra Ligjore për Kadaster	25/11/2019	24/05/2020
15	Qendresë Saraci	Zyra Ligjore	25/11/2019	24/05/2020

(Në rast të më shumë kandidatëve, ju lutem shtoni fushat sipas nevojës)

- 3.2. Të ofroj mbrojtje dhe siguri në punë sipas ligjeve në fuqi dhe kushteve të përshtatshme të punës së pjesëmarrësve;
- 3.3. Punëdhënësi do të caktoj një punonjës kompetent të personeli që është në gjendje të mbikëqyrë dhe udhëheqë pjesëmarrësit. Mbikëqyrësi do të jetë personi ndërlidhës për ALMP 2/UNDP përkatëse;
- 3.4. Të ofroj qasje të lirë për vizitat e monitorimit;
- 3.5. Punëdhënësi ose përfaqësuesi i tij do të merr pjesë në vlerësimin final të kandidatit.

- 3.6. Punëdhënësi njofton zyrën e punësimit nëse ai/a jo nuk është i/e kënaqur me kandidatët brenda 10 (dhjetë) ditëve të para kalendarike nga vendosja e kandidatit në praktikë (periudhës së provës) dhe mund të kërkojë zëvendësim. Nuk do të ketë kompensim për periudhën provuese.
- 3.7. Të mos i largoj punonjësit aktual apo të reduktoj orët e punës së tyre;
- 3.8. Punëdhënësit në mënyrë specifike nuk kanë të drejtë për të angazhuar pjesëmarrës me të cilët kanë marrëdhënie familjare si nënë, baba, vëllai, motra, djali, vajza dhe bashkëshorti/ja.
- 3.9. Në fund të periudhës së praktikës punëdhënësi është i inkurajuar të ofrojë punësim kandidatëve por nuk është i obliguar për ti punësuar ata.
- 3.10. Mbanë evidencën lidhur me vijueshmërinë e pjesëmarrësve dhe të njëjtat i prezanton sipas kërkesës së palëve dhe për nevojat tjera procedurale;
- 3.11. Në rast se punëdhënësi ndërprente marrëveshjen për realizimin e masës me pjesëmarrësin me herët se data e përcaktuar e përfundimit të marrëveshjes për angazhim duke ju referuar dispozitave ligjore për shpërblyerje të njëanshme, atëherë punëdhënësi merr përsipër të informojë zyrën e punësimit me shkrim menjëherë lidhur me përfundimin e parakohshëm të marrëveshjes për angazhim së bashku me arsyetimin e bazuar ligjorë për shpërblyerje të parakohshme;
- 3.12. Nëse pjesëmarrësi i angazhuar në masë e braktisë me herët masën aktive në të cilën është angazhuar pa fajin e punëdhënësit, sipas paralajmërimit paraprak për ndërprerje të parakohshme, marrëveshja për angazhim në masë do të përfundojë. Punëdhënësi merr përsipër të informojë pa humbur kohë zyrën e punësimit dhe ka të drejtë të kërkojë më pas kandidatë shtesë nga lista e aplikuesve përkatëse varësish nga mundësit procedurale dhe të resurseve- masës përkatëse në implementim;
- 3.13. Përbushë të gjitha detyrimet ligjore për realizimin e kësaj mase konform Ligjit 05/L-077, Ligjit 04/L-205, rregullores 01/2018 pa përjashtuar dispozitat tjera ligjore nga fusha e punësimit dhe aftësisimit profesional të ndërlidhura me fushën e bashkëpunimit dhe të drejtave detyimore.
- 3.14. Punëdhënësi do të jetë i hapur për vizitat monitoruese që do të bëhen nga ALMP2-UNDP

Neni 4

Pjesëmarrësit në masën aktive të tregut të punës

- 4.1. Të marrin pjesë rregullisht në implementimin e masës;
- 4.2. Të respektojnë rregullat e brendshme të punës së punëdhënësit;
- 4.3. Të mos i përdorin informatat e përfituara në vendin e punës për ndonjë qëllim tjetër jashtë vendit të punës të caktuar nga punëdhënësi;
- 4.4. Të njoftoj punëdhënësin dhe Zyrën e Punësimit përkatëse mbi ndërprerjen e angazhimit, 7 ditë para ndërprerjes;
- 4.5. Të respektojnë rregullat rreth mbrojtjes dhe sigurisë në punë;
- 4.6. Në raport me të drejtat dhe përgjegjësitë përbushë të gjitha detyrimet ligjore për realizimin e kësaj mase konform dispozitat ligjore nga fusha e punësimit dhe aftësisimit profesional të ndërlidhura me fushën e bashkëpunimit dhe të drejtave detyimore;
- 4.7. Pranon kompensimin mujor financiar prej 150 euro për angazhim në masën e Praktikës në Punë;
- 4.8. Praktikanti merr pjesë në Praktikë në punë jo më shumë se 40 orë në javë.

Neni 5

ALMP 2/UNDP dhe Komuna e Vushtrrisë

- 5.1. Monitoron nga afër implementimin e masës dhe rezultatet që dalin nga ky implementim dhe të ndërmarrë masa korrigjuese nëse është nevoja;

- 5.2. Të respekton të gjitha dispozitat e tjera të përcaktuara në marrëveshjen për angazhim në masën aktive të tregut të punës;
- 5.3. Përfshijmë detyrimet nga paragrafi 5.1.4 barten nga ALMP2/UNDP apo strukturat organizative të saj në rastet kur është në cilësinë e punëdhënësit në implementimin masës.
- 5.4. ALMP2/UNDP nuk është përgjegjëse për ndonjë shpenzim eventual nga dëmet e pajisjeve në punë, shpenzimet nga aksidentet apo sëmundja e pjesëmarrësve gjatë implementimit të masës.
- 5.4.1. ALMP2/UNDP në mënyrë specifike përkrah dhe nuk mbështete të drejtë për të angazhuar pjesëmarrës me të cilët kanë marrëdhënie familjare si nënë, baba, vëllai, motra, djali, vajza dhe bashkëshorti/ja;

Neni 6

Komuna e Vushtrrisë

- 6.1 Kompletion dokumentacionin përkatës për punëkërkesin e papunë dhe e dorëzon aplikacionin të udhëheqesi zyres, i cili në konsultim dhe pajtim se bashku me ALMP2-UNDP e shqyrton dhe aprovon.
- 6.2 Monitoron masën aktive të tregut të punës;
- 6.3 Monitorimi bëhet në vendin e punës së punëdhënësi, në bashkëpunim me ALMP2-UNDP
- 6.4 Monitorimi i masës në vendin e punës duhet të dokumentoj informacionin e marrë direkt nga praktikantii, por duhet gjithashtu të kapë perspektivën e punëdhënësit rreth progresit të zbatimit të masës.
- 6.5 Komuna e Vushtrrisë në mënyrë specifike nuk kanë të drejtë për të angazhuar pjesëmarrës me të cilët kanë marrëdhënie familjare si nënë, baba, vëllai, motra, djali, vajza dhe bashkëshorti/ja;
- 6.6 Procedon listen e përfutësve në zyrën e Punësimit për të regjistruar në SIMP secilin pjesëmarrës veç e veç që është angazhuar në masë aktive përkatëse të tregut të punës;
- 6.7 Pranon fletët e vijueshmërisë dhe përpunon-procedon pranë -ALMP2-UNDP sipas kërkesës për kompensim financiar mujor të përcaktuar sipas masës aktive të tregut të punës;

Neni 7

ALMP2-UNDP

- 7.1 ALMP2-UNDP do të bëjë kompensim direkt për praktikantin në shumë maksimale prej **900.00 Euro** për një praktikant brenda 6 mujorit të Praktikës pas pranimit të dokumenteve të kompletuara, të cilat përgatiten nga këshilltari përkates përmes transferimit bankar duke përdorur formularin e "Vendorit" të bashkëngjitur kësaj marrëveshje. Praktikanti/ja do të pranojë **150.00 Euro** në muaj si kompensim në bazë mujore.
- 7.2 ALMP2-UNDP nuk pranon kurrfarë përgjegjësie për shpenzime që dalin nga aksidentet dhe/ose sëmundjet që shfaqen gjatë programit të praktikës.
- 7.3 Kjo shume do t'iu paguhet drejtpërsëdrejti kandidatëve (në llogarinë bankare) në fund të çdo muaji të masës aktive përkatëse bazuar në listën e prezencës, nënshkruar nga punëdhënësi, e cila dëshmon prezencën e pjesëmarrësit gjatë periudhës së masës
- 7.4 ALMP2-UNDP është përgjegjëse për realizimin e aktiviteteve të projektit si partnerë implementues.
- 7.5 ALMP2-UNDP do të paguaj primet sigurimit për pjesëmarrësit të angazhuar në Praktikë në Punë kundër lëndimeve të mundshme në aksidentet në punë (sigurimi personal nga aksidenti).
- 7.6 ALMP2-UNDP nuk është përgjegjëse për kurrfarë keqpërdorimi ose mospajtuashmërie me termat dhe kushtet e paraqitura në **PRAKTIKË NË PUNË** nga Punëdhënësi, pjesëmarrësin në masën aktive ose përfaqësuesit Komunes si partnerë në procesin e zbatimit, përjashtimisht në rastet e shkaktuara nga vetë përfaqësues të ALMP2-UNDP.

7.7 ALMP2/UNDP nuk është përgjegjëse për ndonjë shpenzim eventual nga dëmet e pajisjeve në punë, shpenzimet nga aksidentet apo sëmundja e pjesëmarrësve gjatë implementimit të masës.

Neni 8

Vizitat Monitoruese

Vizitat Monitoruese do të bëhen nga dy herë për çdo **6 muaj** të angazhimit në masën aktive përkatëse të tregut të punës nga ALMP-UNDP. Punëdhënësi do të mundësojë qasje të lirë në vizita monitoruese.

Neni 9

Abuzimi i të drejtave bazike

Në rast se kandidati ankohet me shkrim për çfarëdo lloj abuzimi i të drejtave të tij/saj, ALMP2-UNDP ka të drejtë për të përfunduar marrëveshjen me punëdhënësin.

Neni 10

Kohëzgjatja dhe Përfundimi i Marrëveshje për realizimin e masës



- 10.1 Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjes është themeluar për **6 (gjashtë) muaj**, që nga data e fillimit të angazhimit të pjesëmarrësit në masën aktive të tregut të punës. Marrëveshja do të shkëputet automatikisht pas skadimit të kohës së lartcekur.
- 10.2 Në qoftë se arrihet në përfundim që punëdhënësi nuk i përmbush kushtet e kësaj marrëveshje ALMP-UNDP dhe praktikanti do të kenë të drejtën për të përfunduar këtë Marrëveshje për realizimin e masës me një njoftim me shkrim brenda afatit të paraparë ligjorë;
- 10.3 Në qoftë se arrihet në përfundim se, ALMP2/UNDP nuk i përmbushin kushtet e kësaj Marrëveshje për realizimin e masës, pjesëmarrësi ka të drejtën të përfundojë Marrëveshje për realizimin e masës në çdo kohë me një njoftim paraprak me shkrim sipas dispozitave ligjore;
- 10.4 Në qoftë se arrihet në përfundim se praktikanti nuk i përmbushin kushtet e kësaj Marrëveshje për realizimin e masës, punëdhënësi dhe ALMP2/UNDP ka të drejtën të përfundojë –shkëputin marrëveshjen në çdo kohë me një njoftim paraprak sipas afatit ligjor.
- 10.5 Çdo palë ka të drejtën të përfundojë Marrëveshje për realizimin e masës me një njoftim paraprak prej 7 ditë.
- 10.6 Palët do të përpiqen për të zgjidhur mosmarrëveshjen miqësisht për çështjet që mund të lindin ndërmjet tyre në realizimin e kësaj kontrate.
- 10.7 Në rast se zgjidhja miqësore nuk arrihet apo pajtimet brenda periudhës së caktuar, mosmarrëveshja do të zgjidhet në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.

Neni 11






Gjuha

11.1 Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën shqipe (dhe në gjuhën serbe dhe nëse kërkohet në gjuhë tjera të pranuar nga Kushtetuta e Kosovës). Në rast të mospërputhjes, versioni në gjuhën shqipe duhet të jetë bazë.

11.2 Kjo Marrëveshje është bërë në 2 (dy) kopje identike në gjuhën shqipe, nga të cilat një (1) mbahet nga Punëdhënësi, një (1) mbahet nga ALMP2/UNDP, në raport me Marrëveshjes NR 61, DATA 08.05.2019.

Për Punëdhënësin:	Për ALMP-UNDP
Zt. <u>Xhafer Tahiri</u>	Zt. <u>Alban Kryeziu</u>
Pozita: Kryetar i Komunës së Vushtrrisë	Menaxher i projektit
Nënshkrimi: 	Nënshkrimi: 
Data: <u>22.11.2019</u>	Data: <u>08.12.19</u>

Dhe Praktikantet

- | | |
|--|--|
| 1. Emri i punëkërkuarit : <u>Majlinda Salihu</u> | Nënshkrimi <u></u> Data <u>29.11.2019.</u> |
| 2. Emri i punëkërkuarit : <u>Linda Gashi</u> | Nënshkrimi <u></u> Data <u>25.11.2019.</u> |
| 3. Emri i punëkërkuarit : <u>Mirjeta Trepca</u> | Nënshkrimi <u></u> Data <u>29.11.2019</u> |
| 4. Emri i punëkërkuarit : <u>Atëdhedona Kosumi</u> | Nënshkrimi <u></u> Data <u>25.11.2019</u> |
| 5. Emri i punëkërkuarit : <u>Syleme Sadiku</u> | Nënshkrimi <u></u> Data <u>25.11.2019.</u> |
| 6. Emri i punëkërkuarit : <u>Liridona Segashi</u> | Nënshkrimi <u></u> Data <u>25.11.2019</u> |
| 7. Emri i punëkërkuarit : <u>Aferdita Kajtazi</u> | Nënshkrimi <u></u> Data <u>25.11.2019</u> |
| 8. Emri i punëkërkuarit : <u>Albanë Xhema</u> | Nënshkrimi <u></u> Data <u>25.11.2019</u> |
| 9. Emri i punëkërkuarit : <u>Doruntina Mulaku</u> | Nënshkrimi <u></u> Data <u>25.11.2019</u> |
| 10. Emri i punëkërkuarit : <u>Diellona Berisha</u> | Nënshkrimi <u></u> Data <u>29.11.2019</u> |
| 11. Emri i punëkërkuarit : <u>Dafina Azemi</u> | Nënshkrimi <u></u> Data <u>25.11.2019</u> |
| 12. Emri i punëkërkuarit : <u>Pajtime Ismajli</u> | Nënshkrimi <u></u> Data <u>25.11.2019</u> |
| 13. Emri i punëkërkuarit : <u>Qendresa Jashanica</u> | Nënshkrimi <u></u> Data <u>25.11.2019</u> |

14. Emri i punëkërkuarit : Zylfije Rekalija

Nënshkrimi



Data 25.11.2019

15. Emri i punëkërkuarit : Qendresë Saraci

Nënshkrimi



Data 25.11.2019